



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 24, date 26/04/2004

**“PËR
PAJISJE ME AUTORIZIM PËR PRIVATIZIMIN E BANESËS
NË RRUGËN “MARGARITA TUTULANI”,
PALLATI I BANKËS SË KURSIMEVE, SHK.1, AP.4”.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore “Për pajisje me autorizim për privatizimin e banesës në rrugën “Margarita Tutulani”, Pallati i Bankës së Kursimeve, Shk.1, Ap.4”, mbështetur në ligjin Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma “e”, në VKM Nr.49, dt.29/01/1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”, në ligjin Nr.8030, dt.15/11/1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, në VKM Nr.530, dt.17/10/1994 “Për mënyrën e ndarjes së apartamenteve të ndërtuara nga Enti i Banesave”,

V E N D O S I;

I.Të pajiset me autorizim zoti Gering Hoxha, i shpronësuar, për apartamentin me strukturë 2+1 në adresën Rruga “Margarita Tutulani”, Pallati i Bankës së Kursimeve, Shk.1, Ap.4.

II.Zoti Rakip Hoxha (i shpronësuar) hiqet nga lista e qytetarëve që kanë aktmarrëveshje të pazbatuara me pushtetin lokal.

III.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore, Enti Kombëtar i Banesave.

IV.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI